



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 33/08**

**Prishtinë, më 2.12.2008, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Bedri Hamza, zv.ministri i MEF-i, Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Behxhet Haliti nga MEF-i, Mentor Osmani nga Kuvendi, Fahri Breznica nga Zyra e Presidentit, Zahir Bajrami nga Zyra e Kryeministrit, Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009:**
  - 2.1. Shqyrtimi buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës**
  - 2.2. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës**
  - 2.3. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

## 2.1. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës

**Kryesuesi**, kërkoi shpjegime nga përfaqësuesit e Zyrës së Presidentit.

**Fahri Breznica**, theksoi se kërkesa e tyre ka të bëjë me trajtimin e stafit civil të Presidentit njësoj si me të Kuvendit si dhe akomodimi i tyre. Gjithashtu njoftoj se ndihet nevoja për mjete shtesë për të mbuluar shpenzimet që krijohen pas formimi të Këshillit konsultativ për komunitete që do të vepron pranë Zyrës së Presidentit, ku është paraparë të krijohet një Sekretariat që do ta udhëheq këtë këshillë. Miratimi i disa ligjeve nga fusha e presidencës shkaktojnë shpenzime shtesë për Zyrën së Presidentit.

**Haki Shatri**, theksoi se të gjitha ligjet që krijojnë obligime prej 1 janarit duhet merren parasysh kostoja e tyre. Sa i përket Këshillit mund të bëni kod të veçantë buxhetor brenda buxhetit tuaj.

**Bedri Hamza, zv.ministër i MEF-i**, theksoi se në momentin që do të fillojë punën Këshilli, do të sigurohen mjetet nga fondi i passtatusit. Aktiviteti i Këshillit nuk do të pengohet në mungesë të mjeteve financiare. Por sigurisht se do të merren parasysh kërkesat e arsyeshme dhe të detalizuara.

**Besa Gaxherri**, duke u ndërlidhur theksoi se është dashur të detalizohet kërkesa lidhur me shpenzimet për sekretariatit e këshillit. Do të duhej specifikime edhe për kategoritë tjera (mallra dhe shërbime si dhe për shpenzimet kapitale).

**Riza Smaka**, theksoi se në bazë të kriterëve të bëhet specifikimi i punëve, paraqitja e projekteve dhe organogrameve, duke pasur parasysh kualifikim të përcaktohen koeficientet dhe të përcaktohen drejtë shumat për kategoritë ekonomike e jo të veprohet në formë të arbitrarizmit. Në këtë formë mund të bëhet edhe kontrolli më i lehtë i mjeteve të shpenzuara.

**Myrvete Pantina**, kërkoi që t'iu ipet një afat që të përgatitet kërkesa për sekretariatit e Këshillit dhe pastaj të inkorporohet në buxhetin e Zyrës së Presidentit.

**Kryesuesi**, theksoi se Këshilli nuk duhet mbetur pa mjete, por se ato duhet sigurohen kur të përgatitet kërkesa e detalizuar. Pyeti se a kanë mjete për gjashtë muaj, ndërsa me rishikim do të plotësohen mungesat financiare.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

### P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah buxhetin e Zyrës së Presidentit të Kosovës për vitin 2009. Me rastin e rishikimit të buxhetit të plotësohen kërkesat e arsyetuara dhe detalizuara financiare.

## 2.2. Shqyrtimi buxhetit të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës

**Kryesuesi**, ia dha fjalën përfaqësuesit të Kryeministrit të shpjegoi buxhetin e tyre.

**Zahir Bajrami**, njoftoi s kërkesat e tyre buxhetore janë harmonizuar me MEF-in. Megjithatë me organograin e ri, për Zyrën për komunitet që vepron në kuadër të Kryeministrit ka lind nevoja për mjete shtesë prej 36,364 €, dhe se aty do të rritet numri i punëtorëve në shtatë persona.

**Kosara Nikolić**, kërkoi sqarime për shumën prej 1 milion € të parapara për Zyrën për komunitete.

**Agim Krasniqi**, duke iu përgjigjur kjo shumë është paraparë për subvencione dhe transfere.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Komisioni përkrah buxhetin e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për vitin 2009 ashtu siq është të prezantuar në buxhetin e Kosovës.

### 2.3. Shqyrtimi buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Kryesuesi**, kërkoi sqarime nga drejtori i buxhetit për kërkesën në fjalë.

**Mentor Osmanaj**, njoftoi se kërkesa është zvogëluar për 1.5 milion € Zvogëlimi ka të bëjë në kategorinë mallra dhe shërbime dhe paga dhe mëditje (për deputetët). Janë hequr një pjesë e shumave në emër të konsulences, dhe për diplomaci. Në këtë mënyrën buxheti i Kuvendit është zvogëluar për 4.82 %.

**Bedri Hamza, zv.ministër i MEF-i**, zvogëlimi i buxhetit të Kuvendit është bërë edhe për faktin e përfundimit të marrjes së mjeteve nga deputetët pasiv. Buxheti i miratuar është i mjaftueshëm për fillimin e punës, duke ditur edhe faktin se dinamika e punëve në vitin e ardhshëm do të jetë më e vogël krahasuar me këtë vit.

**Kryesuesi**, duke i përgjigjur parafolësit tha se Kuvendit do ti shtohen aktivitetet dhe detyrat dhe tanimë nuk do ta ketë përkrahjen që ka pasur më herët. Zgjidhja e statusit ka krijuar edhe obligime të reja për Kuvendi, si krijimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me Parlamentet tjera. Prandaj duhet shikuar mundësia e rritjes së buxhetit të Kuvendit për të mundësuar realizimin e aktiviteteve të tija vitin e ardhshëm nga lëvizjet e brendshme të buxhetit.

**Haki Shatri**, theksoi se ka nevojë për ndërhyrje më qëllim të rritjes së buxhetit të Kuvendit. Krahasim me shumicën e Ministrive, në kategorinë mallra dhe shërbime dhe numrin e punëtorëve, Kuvendi ka numër më të vogël. Nuk duhet penguar puna e Kuvendit për shkak të mungesës së mjeteve. Prandaj zgjidhja duhet bërë duke lëvizur brenda kufijve të përgjithshëm buxhetor pa ndryshuar strukturën e përgjithshme të buxhetit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Komisioni konstaton se më qëllim të përmbushjes së nevoja të buxhetit të Kuvendit. Plotësimi i kësaj kërkesë do të bëhet nga mjetet e buxhetit brenda strukturës së përgjithshme të buxhetore.

### 3. Të ndryshme

U diskutua për organizimin e takimit me ekspertët e sjellur nga GTZ më qëllim të ofrimit të përvojave të tyre në procesin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40

Përgatitur nga  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**